



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 138243

Më: 29 tetor 2024

Pas shqyrtimit të rendit të ditës nga Komiteti për Politikë dhe Financa, për mbledhjen e **X/2024 (dhjetë)** të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e cila do të mbahet më: **31 tetor 2024 (e enjte)**, me fillim në **ora 10:00**, në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në “Shtëpinë e Bardhë”, është rekomanduar ky:

### R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 12 shtator 2024 (mbledhje e jashtëzakonshme) dhe 26 shtator 2024 (mbledhje e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për kursimin dhe ridestinimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale;
5. Raporti financiar janar – qershor dhe janar-shtator 2024;
6. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2023 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2023;
7. Informatë rreth raportit të punës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), për periudhën janar-gusht 2024;
8. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024;
9. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor 2023/2024 dhe informatë rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2024/2025;
10. Raporti i Performancës Komunale për Komunën e Prizrenit, për vitin 2023.

Kryesuesja e KPF-së  
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## **KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**

### **Komiteti për Politikë dhe Financa**

**Nr. 001/060 – 138243**

**Më: 29 tetor 2024**

Ndërsa Komiteti për Politikë dhe Financa, për shkak të ngarkesës së rendit të ditës i rekomandojnë Kuvendit të Komunës që pikat tjera të parapara të rendit të ditës për shqyrtim, diskutim dhe miratim, të mbeten për një mbledhje tjetër të Kuvendit të Komunës. Pikat e rekomanduara që të mbeten për mbledhjen tjetër të Kuvendit të Komunës, janë si në vijim;

- Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për dhënien e dekoratave nga komuna e Prizrenit;
- Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);
- Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.001/011-95083 të datës 18.07.2024;
- Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2027;
- Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Përzgjedhës (DKA);



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## **KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**

**Komiteti për Politikë dhe Financa**

**Nr. 001/060 – 138243**

**Më: 29 tetor 2024**

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2024, shqyrtoi dhe diskutoj pikën e rendit të ditës - Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për kursimin dhe ridestinimin e mjeteve buxhetore ne kategorinë ekonomike te investimeve kapitale.

Përfaqësuesi i DEF z. Halil Lika, deklaroi se ka qenë e nevojshme të bëhen ndryshime për këtë propozim-vendim dhe se materialin të cilin e keni ju me ndryshime do të ju përcillet me e-mail edhe anëtarëve tjerë të Kuvendit të Komunës.

Pas diskutimeve dhe propozimeve Komiteti për Politikë dhe Financa, jep këtë:

### **REKOMANDIM**

I rekomandohet Kuvendit të Komunës, që të shqyrtoj, diskutoj dhe miratoj, propozim-vendimin për kursimin dhe ridestinimin e mjeteve buxhetore ne kategorinë ekonomike te investimeve kapitale.

**Kryesuesja e KPF-së  
Antigona Bytyqi**



## PROPOZIM

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2, pika d), nenit 24 dhe nenit 40 paragrafit 2, pika c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30 pika 1 të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike, nenit 2, nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 25 paragrafi 1 pika c), nenit 27 dhe nenit 72, të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ miratoi këtë:

### VENDIM PËR KURSIMIN DHE RIDESTINIMIN E MJETEVE BUXHETORE NË KATEGORINË EKONOMIKE TË INVESTIMEVE KAPITALE

#### Neni 1

Me këtë Vendim, bëhet kursimi dhe ridestnimi i mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale, në shumën e përgjithshme prej **1.162.075,82€** (një milion e njëqindëgjatëdhjetëdymijë e shtatëdhjetëpesë euro e tetëdhjetë cent).

#### Neni 2

**Kursimet e mjeteve buxhetore sipas projekteve kapitale në shumën prej 1.162.075,82€** (një milion e njëqindëgjatëdhjetëdymijë e shtatëdhjetëpesë euro e tetëdhjetë cent):

- Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Pllanjane" në Pllanjanë, kodi i projektit **40736**, në vlerë prej **5.560.94€(Grant)**; (mbetje nga planifikimi);
- Ndërtimi i objektit të ri shkollor (9 klasëshe) në Gjonaj të Hasit, kodi i projektit **48633**, në vlerë prej **5.550.07€(Grant)**; (mbetje nga planifikimi);
- Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor "Ardhmëria" në Landovicë, kodi i projektit **51175**, në vlerë prej **1.850.59€(Grant)**; (mbetje nga planifikimi);
- Renovimi i tërësishëm i sallës së edukates fizike "Meto Bajraktari" ne Reçane, kodi i projektit **46666**, në vlerë prej **914.22€(Grant)**; (mbetje nga planifikimi);
- Ndërtimi i terrenit sportiv dhe murit mbrojtës në shkollën "Deshmorët e Zhurit" ne Zhur, kodi i projektit **54540**, në vlerë prej **22.500.00€(Grant)**; (mbetje nga planifikimi);
- Ndërtimi i qerdhës ne Fshatin Zhur Prizren, kodi i projektit **54447**, në vlerë prej **50.000.00€(Grant)**; (nuk pritet të implementohet gjate vitit 2024);
- Ndërtimi i qerdhës ne Lagjen Arbana Prizren, kodi i projektit **54449**, në vlerë prej **27.700.00€(Grant)**; (nuk pritet të implementohet gjate vitit 2024);
- Ndërtimi i aneksit për parashkollor ne SHFMU"Motrata Qiriazhi" Prizren, kodi i projektit **54564**, në vlerë prej **30.000.00€ (Grant)** (projekt i anuluar).

**Totali i kursimit për arsim është: 144.075,82€.**

- "Digjitalizimi i shërbimeve të analizave laboratorike", kodi i projektit **54645**, në vlerë prej **100.000.00€**.

**Totali i kursimit për Shëndetësi është:100.000,00€.**

- Ndërtimi I infrastrukturës rrugore në zonën nga Benafi deri në Ortokoll, kodi i projektit **51153** ,në vlerë prej **50,000.00€**;
- Ndertimi i rrugeve lokale dhe kanalizimit ne Randobrave,vazhdim projekti, kodi **87692**, në vlerë prej **25,704.00€**;
- Hapja e rrugës pyjore Udha e Stanëve-Vërmcië,kodi **52591** , në vlerë prej **60,000.00€**;
- Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Lubizhdë të Hasit,vazhdim projekti”,kodi **53819**,në vlerë prej **32,259.00€**;
- Ndërtimi i rrugës Shpenadi-Lubizhdë,vazhdim projekti, kodi **52545**,në vlerë **41,971.00€**;
- Ndertimi i shtratit të Lumbardhit nga ura afer Kampusit Universitar vazhdim të rrjedhes, kodi **52118**, në vlerë prej **160,000€**;
- Ndërtimi I rrugës Zym-Lugishtë e Hasit-Dedaj vazhdim projekti,kodi **89600**,në vlerë prej **16,368€**;
- Rregullimi I kanalizimit në Shkozë,kodi **54091**, në vlerë prej **12,206.00€**;
- Ndërtimi I rrugës me asfalt në Kopana Voda,kodi **54125**,në vlerë prej **70,000.00€**;
- Ndërtimi I rrugës me asfalt Jeshkovë-Lybiqevë,kodi **54126**,në vlerë prej **40,000.00€**;
- Sistemet e Ngrohjes Qendrore,kodi **54146**, në vlerë prej **50,000.00€**;
- Ndërtimi I varrezave te reja në Landovicë,kodi **54543**,në vlerë prej **20,000.00€**;
- Ndërtimi i Muzeut dhe Galerisë së Arteve,kodi **54023**,në vlerë prej **50,000.00€**;
- Kubëzimi i disa rrugëve dhe rregullimi i ndriçimit publik në Vërmicë,kodi **54094**,në vlerë prej **61.492,00€**
- Ndërtimi i urës Vlashnje-Muradem,kodi **54082**,në vlerë prej **50,000.00€**
- Ndërtimi i nënkalimeve,mbikalimeve në Landovicë, Malësi e re, Lutogllavë ,Vlashnje etj,kodi **54033**,në vlerë prej **50,000.00€**
- Ndertimi i Qendres per trajtim te perkohshem te kafsheve Endacake – Dushanove,kodi **54628** në vlerë prej **128.000.00€**;

**Totali i kursimit për Shërbime Publike:918,000.00€.**

### **Neni 3**

**Ridestnimi i mjeteve buxhetore në projektet kapitale në shumën prej 1.162.075.82€ (një milion e njëqindëgjashtëdhjetëdymijë e shtatëdhjetëpesë euro e tetëdhjetëdy cent) , të cekura nga neni 1 të këtij vendimi, bëhet si në vijim:**

- Ndertimi i ashensorit ne SHFMU"Motrat Qiriazii" lagjeja.Kurilë Prizren, kodi i projektit **54547**, në vlerë prej **43,875.82€**
- Ndërtimi i qerdhës ne Lagjen Tusus Prizren, kodi i projektit **53443**,në vlerë prej **100.200,00€**.

**Totali ridestnimit për Arsim është:144.075,82€.**

- “Ndërtimi i QMF-së në KFOR”, kodi i projektit **51098** në vlerë prej **100,000.00€**.

**Totali i ridestnimit për Shëndetësi është:100.000,00€.**

- Rregullimi i trotuareve në unazen e qytetit, Rruget Remzi Ademaj, Adem Jashari,Zahir Pajaziti,Ibrahim Rugova,kodi i projektit **54610**, në vlerë prej **100,000.00€**;
- Instalimi dhe riparimi i ndriçimit publik në Ortokoll,Bajram Curr, Tusus, Arbanë,Jeta e re", Piranë, Zhur, Gjonaj ,Hoqë e qytetit etj,kodi **54586**, në vlerë prej **90,000.00€**;
- Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugeve me asfalt në Ortokoll,Tusus,Arbanë ,Bajram Curri, 11 marsi,2 korriku,në fshatra etj,kodi **54588**, në vlerë prej **200,000.00€**;
- Rehabilitimi dhe ndertimi i rrugeve me kubeza ,trotuareve dhe shesheve ne Ortokoll, Bajram Curr, Arbana, Jeta e re, etj,kodi **54596**,në vlerë prej **50,000.00€**
- Rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellesit në pjesët kryesore të Qytetit,Shadervan,Ortokoll,Bajram Curr, Arbane, etj, kod i **54603** , në vlerë prej **50,000.00€**;
- Ndërtimi i Infrastrukturës (rrugë,kanalizim,ujesjelles etj) Tusus,kodi **52104**, në vlerë prej **70,000.00€**;
- Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në lagjen "Arbana" në qytetin e Prizrenit, kod i **53808** në vlerë prej **10,000.00€**;
- Ndërtimi i rrugeve dhe kanalizimit në fshatrat e Zhupës,kodi **53809**, në vlerë prej **10,000.00€**;
- Ndërtimi i rrugeve dhe kanalizimit në lagjen " 11 Marsi" të qytetit të Prizrenit,kodi **53806**, në vlerë prej **50,000.00€**;
- Ndërtimi i rrugës në Sërbicë e Poshtme-Zojz, kod i **52548**, në vlerë prej **30,000.00€**
- Ndërtimi i kanalizimit të hapur,mureve mbrojtëse dhe rregullimi i rrugicave në fshatin Krushë e Vogel,kodi **52728**,në vlerë prej **70,000.00€**
- Rregullimi i murëve mbrojtese në Komunën e Prizrenit ne Landovicë, Randobravë,fshatra te Zhupës, Has, Vërrri etj, kod i **54021**, në vlerë prej **100,000.00€**
- Ndërtimi i toaleteve publike në zonën e parë të mbrojtur,kodi **54141**,në vlerë prej **50,000.00€**
- Ndërtimi i rrugeve dhe kanalizimit në fshatin Kushnin Has,kodi **53807**,në vlerë prej **38,000.00€**

**Totali i ridestinimit për Shërbime Publike është:918.00,00€.**

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë Përkatëse.

#### **Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KOMUNA E PRIZRENIT**  
**Kuvendi i Komunës**  
**Nr. 001/011-**  
**Më:**  
**P r i z r e n**

**Propozuesi:**  
**Kryetari i Komunës**  
**Shaqir Totaj**